



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:158418

Datë: 16.07.2024

Numri i dokumentit: 05944998

A.nr.1966/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtare, Lirije Maksutaj e me zyrtaren ligjore, Kaltrina Çitaku, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses, S.. K.. të cilën e përfaqëson me aut av.D.. R.. nga P.., kundër të paditurës, Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson, me bazë juridike anulim i aktvendimit, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur, me dt.26.06.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit, S.. K.. ndërsa **Anulohet** aktvendimi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës me Nr.03/603/20-03/1036/2 i dt.28.09.2020 dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosi tek e paditura.

A r s y e t i m

Paditësi i lart cituar si në e padi e parashtruar me dt.16.11.2020 3.07.2018 por dhe në seancën e shqyrtimit kryesor ka mbutuar si ne padi kërkesëpadie. Theksoj se fjala është për korrigjimin e mbiemrit për M..N..e cila në vitin 1982 e ka blerë patundshmërinë kontestuese nëpërmjet kontratës së shitblerjes të cilën e ka blerë prej Ç..S..nga Peja si shitës dhe M.. N..nga P..nga ana tjetër si blerëse e patundshmërisë. E njëjta kontratë është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Pejë dhe si e tillë është e plotfuqishme dhe valide. E ku ne ndërkohë M.. N..ndërron jetë dhe patundshmërinë në fjalë e trashëgon vajza e saj N..N... nga B... Kanë sqaruar së procedura trashëgimore është zhvilluar në pasi kanë jetuar atje me datën 30.06.2009. Në ndërkohë nuk është bërë bartjen e pronës së trashëguar në emër të N.. N. Në vitin 2009 N.. N..ndërron jetë dhe në vitin 2012 hapet procedura për trashëgimin e pronës të M..N.. kështu që Sana K... vajza e N.. N..e trashëgon pronën e cila ende mbahet e figuron në emër të M.. N.. (gjyshja e S..K..) tani paditëse në këtë padi. Pala paditëse ka bërë kërkesë në Pejë duke paraqit dhe Aktvendim të

Gjykatës të parë Themelore në Beograd e ku ka marre vendim refuzues që ti bëhet bartja e pronës me pretekst që prona është e në emër të M..J.., atëherë kane iniciua procedurën për përmirësimin e mbiemrit sepse ka qenë evidente me rastin e bartjes të shënime Drejtësisë per Gjedozi dhe Kdaster KK Pejë per shak se në mënyrë elektronike në data bazë është bërë gabim në mbiemër nga shkronja N në J dhe në vend të N..në J.. dhe kemi përfunduar në gjykatën themelore. Me që janë ofrua të gjitha dëshmitë kërkoj nga kjo gjykatë që të obligoj AKK-në në Pejës që të bëj korrigjimin e mbiemrit J.. në N.. gabim i cili është i atij organi, ngase ekzistojnë dokumentet burimore në të cilat konstatohet që prona e regjistruar në emër të M..N.. ngase ekzistojnë të gjitha dokumentet të cilat dëshmojnë së prona që nga fillimi është e regjistruar në emër të M.. N...

E padatuara në përgjigjen në padi ka theksuar se e kanë shqyrtuat ankesën e ankueses pretendimet e saj i ka refuzuar si të pabazuara për ti bërë korrigjimin e te dhenve kadastrale e cila ka te bej me mbiemrin e titullares se pronës në regjistrin e te drejtave te pronës se paluajtshme në njësinë kadastrale me numër 00286-7 dhe numër 00286-8 ZK Pejë nga mbiemri J.. në mbiemrin N..pa ofruar ndonjë dokument që do të vlerësohej si provë relevante për korrigjim e mbiemrit. Po ashtu kane theksuar se pala nuk ka ofruar prova shtesë që di ti vlenin sipas neni 17 te Ligjit 04/1-013 për Kadaster apo UA nr.11/2019 për regjistrimin dhe ndarjen e parcelës. Nga këto arsye gjykatës i kanë kërkuar që padia e paditëses te refuzohet si pabazuar dhe vërtetohet vendimi i kontestuar me padi.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.26.06.2022, ka bërë administrimin e provave dhe atë: Vendimi i AKK-së i dt. 28.09.,2020 nr. prot.03/603/20-03/1036/2; Aktvendim i zyrës kadastra le në Pejë i dt. 11.03.29020 nr.01-516/2019; Ankesa e ankueses e dt. 15.05.2020; Certifikata mbi palujtshmërinë e datës 23.11.2018; Kontrata e shitblerjes e dt. shtator.1982 vërtetemi i kantatës 11.10.1982, Kopja e planit 02.06 1982. Fleta poseduese nr.7288 ; Vendim i dt. 15.03.2012; vendim i dt. 30.06.2009; Certifikata e lindjes për N.. N. , certifikata e vdekjes e dt. 16.09.2009; Certifikata e vdekjes për M..N.. e dt. 07.05.2009; kërkesë e dt. 05.06.2020; certifikata e vdekjes të I.. N..i dt.23.11.2018; Certifikata e lindjes për N.. N.. e datës 25.07.2005; Ankesa e datës 11.03.2020; Historiati mbi pronësinë nr.prot 01/29 .

Gjykata në përputhje me nenin 44 të LKA-së, në bazë të provave të administruara, përgjigjes ne vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e **bazuar**.

Në procedurën e ankesave organi i paditur AKK me vendimin Nr.03/60320-03/1036/2 i dt.28.09.2020 ka refuzuar ankesën e paditësit si të pa bazuar dhe ka vërtetuar aktvendimin e organit të shkallës së parë, Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër KK Pejë, Nr.01-516/2019 të dt.11.03.2020 .

Nga vendimi i kontestuar konstatohet se ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 48 të këtij ligji është paraparë se “1. Arsytimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsytimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”.

Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i pa qartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar.

Meqenëse pala paditëse ka ofruar provë historiatin mbi pronë me Nr.prt.01/29 ZK Pejë të siguruar e ku nga e cila konstatohet së në vitin 1980, futja e shënimeve elektronike e bërë Shkup, fitojnë fletën poseduese nr.7288 në ngastrën kadastrale nr.286 m², sipërfaqe 104 m² dhe nr.286-4, me sip.12m² në ZK Pejë të cilat janë në pronësi znj. M.. N... Prandaj pasur parsyesh faktin e historiatit te pronës, gjykata vlerësoj se organet administrative kanë dështuar të vetëtojnë faktin nëse M.. J.. është në të vërtet M..N.. Po ashtu meqë organet administrative Drejtoria për Gjedozi dhe Kdaster KK Pejë por dhe e paditura nuk janë të thirrura për korrigjim të shkronjës N në J pra nga M.. J. ne M.. N., gjykata e obligoj të paditurën që në rivendosje të obligoj organin e shkallës së parë që udhëzoj palën ankuese, e këtu paditësen ti drejtohet organit kompetent, pra të filloj procedurën administrative për të zgjidhë çështjen parapake, korrigjimin e shkronjës . E që dhe mund te jete ky një lëshim teknik nga vet organi administrativ e për çka në këtë rast nëse

vërtetohet fakti se M.. J. është në të vërtet si pretendon pala paditëse M.. N.. E qe për vendosje të këtij korrigjimit kompetent është Zyra e Regjistrimit civil në KK Pejë nga i cili epillog varet dhe zgjidhje e kësaj çështje.

Gjykata e obligon organin e paditur që në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim që pasi ti administroj provat të vlerësoj dhe të njëjtat të nxjerrë aktvendim që përmban element që kërkohet në pajtim LPPA-se, e i arsyetuar mbi perëndimet e ankuesit në lidhje me ankesën .

Gjykata si rregull, në konfliktin administrativ e vendosë në bazë të gjendjes faktike, të vërtetuar nga ana e organeve administrative ndërsa nga aktvendimi i goditur në padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike me rastin kur është refuzuar kërkesa respektivisht ankesa e ankueses për regjistrimin e plujtsheriesë me regjistrin kadastral .

Te metat e cekura si me lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në afat prej 30 ditësh, në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr aktvendim të drejtë të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, bazuar në nenin 65 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 43.1, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative,

A.nr.1966/2020, dt.26.06.2024

G j y q t a r e

Lirije Maksutaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.